

# KËRKESE PËR RISHQYRTIM

*Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Për: **K.K. SKENDERAJ**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

<b>Nr i Prokurimit</b>	<b>643-24-2330-5-5-8</b>
<b>Nr i brendshëm</b>	

Sa i përket tenderit për

## 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj **INFINITT SH.P.K.**  
NUI **601614177**  
Adresa **rr.28 Nentori, no.121**  
Vendi **Prishtine**  
Kodi postar **10.000**  
Numri Telefonit **044/974-590**  
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj **Astrit Uka**  
Adresa elektronike **infinitt.shpk@gmail.com**  
Data e parashtrimit të kërkesës **09.09.2024**

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-i  
Adresa elektronike t

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

**Ftese per ofertim kemi pranuar me 14.03.2024.**

**Afati i fundit për dorëzimin e ofertav: 25.03.2024.**

**Data dhe ora e hapjes se ofertav: 25.03.2024. ora 14:00**

**Njoftimi mbi vendimin e AK: 02.05.2024.**

**Pas ankeses ne OSHP lenda eshte kthyer ne ri-vleresim**

**Njoftimi mbi vendimin e AK ne ri-vleresim eshte nxjere me 04.09.2024.**

**Kriter per dhenie te kontrates: Tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet**

#### **4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet**

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po

Jo

#### **5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po

Jo

#### **6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 1- Qellimi

Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 27- Dosja e Tenderit

Neni 28- Specifikimet teknike

Neni 52.3- Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës

Neni 56.3- Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 59.4- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60- Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 30 I Rrpp- Validiteti i Tenderit

Neni 44.2 dhe 44.3 I Rrpp- Formularët Standard

## **7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

AK/Komisioni vlersues gjatë ri-vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ për prokurim publik. AK/zyra e prokurimit me 02.05. ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe letrat standarde per OE ofertues ku eshte rekomanduar per kontrate oferta e kompanise sone si tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet per kete aktivitet te prokurimit. Pas dorezimit te kerkeses per ri-shqyrtim nga OE Botek shpk dhe me pas anekses ne OSHP lenda eshte kthyer ne ri-vleresim.

Me 04.09. AK ka nxjere njoftimin mbi vendimin ne ri-vleresim dhe eshte rekomanduar per kontrate OE Botek sh.p.k.

Kompania jone eshte eleminuar me arsyetimin se:

Ne oferten tuaj nuk keni bashkangjitur katalogun me specifikime teknike te ofruara ne kolonat ku jane specifikuar paisjet e kerkuara, prandaj vleresohet si oferte e papergjegjshme me cmim me te ulet.

Konstatimi i AK/komisionit ri-vleresues nuk qendron, arsyetimi per eliminimin e ofertes sone eshte jo-ligjor dhe i pa drejte. AK/KK Skenderaj ka eleminuar se nuk kemi dorezuar broshurat e produkteve dhe nuk kemi cekur brendin e ofruar.

Ky konstatim i AK/komisionit vleresues nuk qendron, ne ftesen per oferte te perpiluar

nga AK/ KK Skenderaj tek neni IV. Kushtet e tenderit eshte kerkuar te dorezohen dokumentet si ne vijim: Certifikata e Biznesit, Certifikata e TVSH-se, Katalogu me specifikime teknike dhe vertetimi i ATK-se, Certifikata e gjykates si dhe tek aneks 1 eshte kerkuar te dorezohen broshurat e produkteve.

Te gjitha kerkesat e lartecekura kompania jone ka dorezuar/plotesuar.

Eshte dorezuar katalogu me specifikime teknike per te gjitha produktet ne paramase.

AK KK Skenderaj nuk ka specifikuar/kerkuar ndonje dokument shtese. Poashtu ne **nenin VI.2) te FPO-se/ VLERËSIMI I TENDERIT eshte cekur Tenderët e pranuar me kohë do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në bazë të kërkesave të parashtruara në këtë FPO. Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur është në përputhje me të gjitha kërkesat e kësaj FPO.** Bazuar ne dispozitat ligjore te ligjit per prokurim publik ne fuqi, neni 52.3/ 56.3 dhe 59.4 AK i ndalohet qe gjate vleresimit te ofertav te perdore kriteret jo te matshme te cilat me pare nuk jane specifikuar/ percaktuar ne njoftimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit ne kete rast ne Ftese per ofertim.

Citoj nenin 52.3 te LPP-se

Neni 52 - Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës

**3. Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim.** Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kriteret që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kriteret e tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistencat teknike.

Citoj nenin 56.3 te LPP-se

Neni 56- Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

**3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociatë, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.**

Citoj nenin 59.4 te LPP-se

**4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.**

Bazuar dhe ne kushtet e kontrates se lidhur me AQP, citoj nenin 4.3 ne faqe 3 te kontrates: Sa here qe shfaqet nevoja per furnizim, autoriteti kontraktues pergadite ftesen per kuotim (FPK) dhe do te leshoje FPK per te gjitha palet e kontrates publike kornize. **Vleresimi i kontrates ndihmese do te bazohet ne kriteret e theksuara ne FPK.** Në një situatë të tillë AK duke mos specifikuar në FPO se dokumenti i specifikimeve teknike duhet të dorezohet dhe të përfshijë edhe informatat për modelet dhe specifikimet e pajisjeve të ofertuara, si informata të cilat kërkohen nga kushtet e marrëveshjes bazë, ka lënë mundësinë që OE-të të ofertojnë pa dhënë informacion se me cilat produkte ofertojnë. Kompania jone eshte kualifikuar ne AQP me brendin HP dhe broshurat te cilat kemi dorezuar ne ofertim me 25.03.20234.

Marrëveshja kornizë lidhur me AQP-në dhe mini tenderët duhet ti përmbahen nenin 54.40 të rregullores për prokurim publik me nr. 001/2022 Zhvillimi i procedurës (mini tenderimi) në rastet e aktiviteteve të prokurimit qendror të zhvilluar nga ana e Agjencinë Qendror të Prokurimit në emër të Autoriteteve të tjera kontraktuese duhet të zhvillohet nga vetë Autoriteti kontraktuese kurdo që lind nevoja. Ndërsa neni 54.41 parasheh që Mini-tenderimi duhet të jetë në bazë të kushteve të njëjta dhe nëse është e nevojshme sipas termeve të formuluar si dhe kurdo që është e përshtatshme termave të tjera të cilave ju referohet specifikimi në kontratën publike kornizë. Kjo i nënshtrohet ndalimit (shmangie ose kufizime esenciale) prej termave të përcaktuar në kontratën publike kornizë.

Pershkrimi i specifikave teknike ne dosjen e tenderit nuk eshte kerkuar si kriter ne FPO por perderisa jane dorezuar broshurat e produkteve me specifikime teknike, kjo qeshtje e mbulon dhe kriterin/pretendimin e aluduar nga AK per specifikime teknike.

Nderhyrja eventuale ne paramase dhe pershkrimi i brendit&modelit konform nenit 44.3 te Rrpp do te bente oferten e kompanise tone si te papergjegjshme.

Sipas nenit 44.3 te RrPP operatoreve ekonomik ofertues nuk u lejohet nderhyrja ne pershkrimin e cmimeve apo dokumentet tjera te dosjes ne perjashtim te vendosjes se logos ne dokumente apo shenime te kompanise, Rrjedhimisht paramasa/pershkrimi i cmimeve ngarkuar ne sistem nga KK Skenderaj nuk ka hapesire ku do te duhej te cekej brendi apo modeli i paisjev prandaj cdo nderhyrje eventuale e jona tek pershkrimi i cmimeve do te bente oferten te papergjegjshme.

Lidhur me kete qeshtje citojme vendimet e OSHP-se me nr protokoli 356, 373, 389/23 te cilat po ju bashkangjesim me ankese poashtu interpretimin e KRPP-se te leshuar me date 16.03.2023. ne baze te cilit dhe duke ju referuar nenit 44.3 te RrPP operatoreve ekonomik ofertues nuk u lejohet nderhyrja ne pershkrimin e cmimeve apo dokumentet tjera te dosjes ne perjashtim te vendosjes se logos ne dokumente apo shemie te kompanise.

AK/komisioni vleresues perveq qe ka vendosur te eliminoje kompanine tone pa baze ligjore, ne anen tjetere ka rekomanduar per kontrate OE te papergjegjshem te cilit i ka skaduar validiteti i ofertes dhe sigurimi i ofertes me 22.06.2024.

Konform nenit 30 te Rrpp dhe interpretimit te KRPP-se, citoj:

**7. 22.11.2022 Periudha e validitetit të ofertës ka skaduar derisa lënda ka qenë në shqyrtim në OSHP dhe aktiviteti i prokurimit ka qenë në pezullim. A mund të nënshkruhet një kontratë publike pa validitet të ofertës?**

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, KRPP ofron interpretimin ligjor si në vijim: Neni 30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, përcakton: “30.3 Periudha e validitetit të tenderit e specifikuar në dosjen e tenderit do të ndryshoj varësisht nga kompleksiteti i prokurimit. periudha e kërkuar e validitetit do të jetë jo më shumë se që është e nevojshme, dhe do të jetë e mjaftueshme për AK të bëjë vlerësimin e tenderëve të pranuar dhe të bëjë dhënien dhe nënshkrimin e kontratës”. Neni 30.4 i Rregullores për Prokurimin Publik, përcakton: “30.4 Në situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkojë nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit dhe duhet të ngritet në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)” “30.5 Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkohet që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre”. Sipas nenit 30.4 të lartcekur, nuk përcaktohet sa ditë para skadimit të validitetit të ofertave mund të kërkohet zgjatja e afatit të validitetit të ofertave. Megjithatë, është e rëndësishme që të ketë kontinuitet midis afatit të skaduar dhe atij të ri, për këtë arsye në këtë dispozitë thuhet: "para datës së skadimit...." Pavarësisht se aktiviteti i prokurimit është në "Pezullim", AK në përputhje me nenin 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik duhet që të kërkojë zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Asnjë dispozitë e LPP-së dhe e legjislacionit dytësor, nuk përcakton përkufizimin e fjalës "Pezullim", megjithatë, KRPP konsideron se fjala "Pezullim" në kuptim të këtij ligji duhet të nënkuptojë mosndërmarrjen e ndonjë hapi në procedurat e prokurimit për derisa aktiviteti i prokurimit është i pezulluar.

(Psh: hapja e tenderëve nuk duhet të bëhet nëse aktiviteti i prokurimit është pezulluar si rezultat i Kërkesës për rishqyrtim e parashtruar në AK, apo e një ankese e parashtruar në OSHP gjatë fazës së tenderimit, apo nënshkrimi i kontratës nuk duhet të bëhet për deri sa aktiviteti i prokurimit është në pezullim si rezultat i parashtrimin të një kërkesë për rishqyrtim në AK, apo një ankese në OSHP) Neni 30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, kërkon rreptësisht që oferta të ketë validitet deri te dhënia dhe nënshkrimi i kontratës. Prandaj KRPP konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës. Për këtë arsye, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet me kujdesin më të madh të përcjellë validitetin e ofertave, dhe në çdo rast duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohet zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit. KRPP do të monitorojë me kujdes të veçantë autoritetet kontraktuese për moszbatimin e nenit 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik. Mos zbatimi i nenit 30.4 klasifikohet si shkelje e rëndë sipas nenit 97 të kësaj rregulloreje,

andaj KRPP do të ndërmarr masa në përputhje me nenin 97 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Asnje kontrate publike nuk mund të nënshkruhet në rast se validiteti i ofertës ka skaduar. Aq më tepër kur vetë OE Botek sh.p.k. në ofertim ka dorëzuar deklaratë shtese me anë të ciles deklaronte se validiteti i ofertës për projektin në fjalë është 90 ditë.

Bazuar në faktet e lartcekura konstatohet se AK/ KK Skenderaj nuk ka bërë vlerësim të drejtë të ofertave për aktivitetin e prokurimit në fjalë dhe kompania jone është eliminuar pa të drejtë megjithatë kemi qenë oferta e përgjegjshme me çmimin më të ulët për këtë aktivitet të prokurimit. Prandaj kërkojmë nga zyrtari përgjegjës i prokurimit që të rriemerojë komisionin vlerësues dhe nën mbikqyrjen e tij si person përgjegjës lenda të kthehet në ri-vlerësim, vlerësimi i ofertave të bëhet bazuar në kriteret e parashtruara në ftesën për ofertim.

## 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Si pasojë e shkeljeve të lartcekura nga AK/komisioni vlerësues ka ardhur deri tek eliminimi i kompanisë sone pa të drejtë dhe dhenia e kontratës për OE të papërgjegjshëm, në këtë mënyrë na është mohuar fitimi simbolik i paramanduar nga kjo kontratë dhe janë shkelur dispozitat ligjore të lartcekura.**

**Kërkojmë nga zyrtari përgjegjës i prokurimit që pas shpërndarjes së provave dhe fakteve të aprovojë ankesën (kërkesën për ri-shqyrtim) si të bazuar, lenda të kthehet në ri-vlerësim.**

## 9. Lista e dokumenteve (dëshmi) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.